

## **ABSURDITY AND THE LOSS OF WAR ETHICS IN THE NOVELS OF PETRO MARKO AND ERNEST HEMINGWAY**

## **ABSURDITETI DHE HUMBJA E ETIKËS SË LUFTËS NË ROMANET E PETRO MARKOS DHE ERNEST HEMINGWAY-T**

**Emine SHABANI<sup>1</sup>**

<sup>1\*</sup> *Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

<sup>\*</sup> *Corresponding author e-mail: emine.shabani@unite.edu.mk*

---

### **Abstract**

Topic Absurdity and the loss of war ethics in the novels of Petro Marko and Ernest Hemingway, war is presented as a state of madness and meaninglessness by those who invented it. We find this unequal human conflict where real life and literary motivation interweave with each other, in the novels of Petro Marko between Italians and Albanians, while Ernest Hemingway talks about the absurdity of the Italian-Austrian war and the war between Francoists and Republican forces of volunteers from all over the world. Two writers and two fighters who experienced great challenges during these conflicts, transformed and immortalized all the experiences, ideas, perspectives, and worldviews of this war into works of art, thereby creating their original universe. Otherworld and European authors also wrote novels on the subject of war, such as Erich Maria Remarque, known for his famous work *Nothing New on the Western Front*, published in 1929. Remarque himself was on this front for ten days and saw it for namely the futility and inequality of war. The war lost him forever, the aura of honor he had until then.

**Keywords:** poetics of war novels, narration, absurdity, loss of war ethics.

### **Përmbledhje**

Tema Absurditeti dhe humbja e etikës së luftës në romanet e Petro Markos dhe Ernest Hemingway-t, lufta është paraqitur si gjendje e çmendurisë dhe e pakuptimësisë së atyre që e shpikën. Këtë konflikt jo të barabartë njerëzor ku gërshetohen jeta e vërtetë dhe nxitja letrare me njëra-tjetrën, e hasim tek romanet e Petro Markos mes italianëve dhe shqiptarëve, ndërsa Ernest Hemingway, flet për absurditetin e luftës italo-austriake dhe luftën mes frankistëve dhe forcave republikane e vullnetarëve nga e gjithë bota. Dy shkrimtarë dhe dy luftëtarë që përjetuan sfida të mëdha gjatë këtyre konflikteve, gjithë përvojën, idetë, këndvështrimin dhe botëkuptimin e kësaj lufte e shndërruan dhe përjetësuan në vepra artistike, duke krijuar me këtë universin e tyre origjinal. Romane me temë lufte shkruan edhe autorë tjerë botërorë dhe evropian, si Erich Maria Remarque, i njohur me veprën e famshme të tij *Asgjë e re në frontin përëndimor*, i botuar më 1929. Vetë Remarque, qe

---

<https://doi.org/10.62792/ut.filologjia.v12.i22-23.p2505>

---

dhjetë ditë në këtë front dhe e pa për së afërmi kotësinë dhe pabarazinë e luftës. Lufta e humbi përgjithmonë, aurën e nderit që e kishte deri atëherë.

*Fjalët kyçe:* poetika e romaneve të luftës, narracioni, absurditeti, humbja e etikës së luftës.

---

## Metodologjia

Në këtë studim kam shqyrtuar literaturë teorike nga klasikët e narratologjisë: Roland Barthes, Mieke Bal, Julia Kristeva, Fridman, G. Prince, U. Eco, Tz. Todorov, G. Bashlar, M. Bakhtin, L. Goldman, J. P. Sartre etj. Për çështjet teorike, të ndërlidhura me artin e fjalës dhe fiksinin, janë zgjedhur emrat e Terry Eagleton, J. Caller, M. Solar. Për fokalizimin, V. Shkllovski, V. Propp, për strukturalizmin R. Barthes, C.L. Stross, V. Bitti, Umberto Eco, për personazhet modeli aktancial i Greimass-it, S. Chatman, për narratorin dhe kohën në tekstin letrar: Gerard Genette, për intertekstin: J. Kristeva.

Si dhe klasikët e shkencës së letërsisë/teorisë së prozës: E. Auerbach, M. Becket, V. Bitti, R. Wellek, O. Warren, F. Dado, R. Jakobson, J. Lotman, Ch. K. Ogden, që janë kapituj të veçantë në veprën e Škreb, Z. & Štamać, A. Hyrje në letërsi, teori dhe metodologji, si dhe K. L. Stross, Tz. Todorov, etj.

## Hyrje

Tema Absurditeti dhe humbja e etikës së luftës në romanet e Petro Markos dhe Ernest Hemingway-t na lidh me ngjarjet konkrete të një epoke të caktuar të historisë njerëzore. Në këtë kontribuan edhe romanet që u shkruan nga pena të mprehta të kohës, duke filluar nga Iliada e Homerit, por edhe shkrimtarët që përjetësuan kujtimet e luftërave të mëvonshme, si: Remarque, *Dalton Trumbo* me *Xhoni u nis për në luftë*, Henri Barbussea *Nën zjarr*, Ernst Juenger me *Furtuna e çeliktë*, Jarosllav Hashek me *Luftëtari i mirë Shvejk*, Robert Graves *Lamtumirë të gjithave*, Wiliam Faulkner *Paga e ushtarit*, *Në qoftë se vdes duke gënjyer*, Georg Orwell *Homazh për Katalonjën*, Ernest Hemingway *Lamtumirë armë*, *Për kë bie kambana*, Joseph Heller, *Catch 22*, Michael Shaara *Engjëjt vrasës*, Sebastian Faulks *Kënga e zogut*, Boris Pasternjak *Doktor Zhivago*, *Shollohov*, *Doni i qetë*, etj.

Ndërsa lufta ka qenë pjesë e pandarë e jetës së njerëzve në periudha të caktuara historike, këtë e dëshmon edhe vepra e tragjedianit antik *Persët* e Eskilit dhe *Iliada* e Homerit mbi temën e të cilit u shkruan dhjetëra vepra tjera me përmbajtje intertekstuale në kohërat më të reja.

## Diskutimi

Romanet *Për kë bie kambana*, *Lamtumirë armë* të Hemingway-it dhe *Hasta la vista*, zënë hapësirën më të madhe të këtij studimi, të cilat, krahasohen dhe interpretohen, edhe me veprat si *Një Natë dhe dy Agime*, *Asgjë e re nga fronit perëndimor*. Strategjia rrëfimore e luftës, te këto vepra paraqitet si aventurë e rrezikshme dhe e veçantë për shkak të rrezikut që bart ajo për qytetarët, pleqtë e fëmijët. Tendenca e autorit është që me lajmet, letrat dhe shkrimet në gazeta, të shërojë jo vetëm zemrat e vrara të njerëzve por edhe ta ngrejë moralin e shokëve të burgut, duke e përdorur si element inkurajues, nxitje e motiv, të një grupacioni shoqëror në skaje të ekzistencës. Gjurmët rrëfimore që paraqiten në këto romane me tematikë historike dhe karakter autobiografik, përfaqësojnë luftëne bashkësisë njerëzore të cilën e zhvendos në atë (shtazore, bimore e materiale) në planin e jashtëm (raporti me botën e jashtme dhe marrëdhëniet me personazhet tjera) dhe në planin e brendshëm (atë rrëfimor).

## Humbja e etikës së luftës

Te *Lamtumirë armë* të Hemingway-it lexojmë aventurën e rrezikshme të luftës në të cilën është përfshirë Frederic Henry me Rilandin, Passini-in dhe Catheryn Berkly-n infermieren suedeze. Ajo që e karakterizon prozën e Hemingway-it, është stili i iceberg-ut, fjalia e shkurtër dhe e qartë, i njohur si minimalist i shkrimit dhe rrëfimit, që nuk ndalet në përshkrime të gjata dhe apele lirike, flet me asociacione dhe lë për tu nënkuptuar, fokusi tek syri i kamerës, erforma e rrëfimit me narratorin intradiegetik, zhvendosjet narrative në diskursin e protagonistit, etj.<sup>1</sup>

Stilizimi gjuhësor në situata, rrëfimore që përsëriten, siç janë takimi i njerëzve të lodhur, të uritur, mosbesimi ndaj atyre që imponohen, toni real dhe i besueshëm i situatave rrëfimore, etj. Studimi kap elemente të veçorive tematike, temat bosht dhe nëntemat që rrjedhin nga ajo, ideologjia, ndërlikueshmëria në tipologjizimin e personazheve dhe veprave në mënyrë krahasuese.

Përqendrimi është i fokusuar në hulumtimin e ligjshmërive të ndërtimit të brendshëm (aspekti psikologjik) dhe të jashtëm (aksionet dhe dinamizmi i tyre nga personazhet), të strukturës së veprave (Kapitujt, episodet, makrostruktura e stilit, polisemia dhe semiotika, e figuracioni), duke e lidhur me raportet jashtë tekstore shoqërore, historike, rrethanat politike (fazat dhe shenjat e hershme të paraqitjes së luftës, krizat botërore energjetike, ekonomike, financiare të inskenuara etj. ) të kohës kur jetuan dhe vepruan autorët. Koha kur jetoi dhe veproi Petro Marko, që e mbushur me ngjarje të mëdha e vendime të rëndësishme për rregullimin e fatit të popujve ballkanas, e në veçanti fatin e popullit shqiptar.

Te *Një natë dhe dy agime*, është përfshirë periudha në prag të luftës së parë botërore, të cilën e ndërlidh me fatin e babait të tij i internuar në Ustikë. Periudhën pas pavarësisë së Shqipërisë, gjatë së cilës nisën luftërat ballkanike, si dhe lufta e parë dhe dytë botërore. Koha mes dy luftërave botërore, ishte amplitudë e thurjes së fatit dhe gjetje e rrugës për pavarësi e paqe, për shumë popuj e shtete në Europë e më gjerë. Shtrirja e historisë në vepër është shkruar me beletristikën e lindur të autorëve dhe me format rrëfimore horizontale (raportet e jashtme të personazheve me realitetin brenda tekstit letrar) dhe vertikale ose (shtresëzimi narrativ i shkallëzuar), si dhe diagonalen e kuptimit.<sup>2</sup>

Titujt e veprave janë të natyrës filozofike, mitologjike, historike, figurative, kjo varet nga tipi i diskursit dhe narracionit që vetë vepra ia dikton autorit. Romanet e Petro Markos pothuajse të gjitha janë të ndërtuara dhe të kombinuara me personazhe realë dhe të imagjinuar, e cila tregon për ndikimin e faktorit historik e politik, jashtëtekstor dhe intertekstual. Lexuesi nuk mund tu shmanget mendimeve që sugjeron titulli p.sh., vepra *Një natë dhe dy agime*, tërheq vëmendjen e tij tek dykuptimësia që ka titulli. Në kapitullin *Agim* që është i pari, ai lexon me vëmendje dhe hulumton, se ku do ta gjejë misterin ose enigmën e këtij kapitulli dhe kuptimin alegorik të tij. Nata kapitulli i dytë, është më voluminozi, lexuesi përqendron vëmendjen që në fillim tek titulli sugjerues. Ai është në pritje gjatë leximit, që ta zbërthejë këtë titull domethënës dhe metaforik.<sup>3</sup>

Përhëndetja spanjolle *Hasta la vista* u bë titull tërheqës e interesant i romanit që përjetësoi kujtimet, emocionet, bëmat dhe peripecitë e luftës së Spanjës, të shikuara nga këndvështrimi i autorit të implikuar në roman. Që në fillim të tërheq vëmendjen dhe të bën kureshtar në zbërthimin e enigmës së veprës. Ky titull përfaqëson fundin e veprës dhe përhëndetjen lamtumirëse të dy personazheve kryesorë, Gorit dhe Anitës. Titujt e veprave të Ernest Hemingway-it kanë kuptim, historik, bibliik dhe metaforik.

<sup>1</sup> Floresha Dado, (2010), *Poetika e prozës*, Albas, Tiranë, f. 182.

<sup>2</sup> Umberto Eco, (2010), *Struktura e papranishme*, Dukagjini, Pejë, f. 83.

<sup>3</sup> Petro Marko, (1978), *Nata e Ustikës*, Rilindja, Prishtinë, f. 17.

Ndërsa Hemingway Për kë bie kambana, e titulloi në përshtatshmëri me ngjarjen që trajtohet në roman, e që është analoge me epigramën e meditimeve të John Donnes-it. Për titullin Lamtumirë armë është frymëzuar nga poema me të njëjtin titull të dramaturgut George Peele të shekullit 16 (1558-1597), i cili këtë poemë ia kushton mbretëreshës Elizabeta. Duke u bazuar në titujt e veprave të Ernest Hemingway-it dhe Petro Markos, vërejmë ndikimet dhe përmbajtjet e tyre në romanet respektive. Marko në romanin Hasta la vista materialin rrëfyes, e vë në shërbim të digresioneve retrospektive dhe perspektive.

Si vepër e parë romanore, autori ka përmbledhur gjithë ngjarjet reale dhe të imagjinuara duke i dhënë kolorit stilit dhe formave rrëfimoretë ndara, realitetin e imagjinuar, të ndërlikuar dhe të shtresëzuar, ose rrëfimin real, për jetën e bashkëluftëtarëve e vullnetarëve shqiptarë, me aktorët që u takojnë moshave të ndryshme. Por edhe rrëfimi që posedon dinamikën e vetë dhe bazohet më shumë në fokusin specifik të botës, në të cilën me entuziazëm formësohen portretet e personazheve, të profilizuara nga aspekti etik e psikologjik. Nga kjo mund të thuhet se në themel të këtyre kriterëve poetologjike, duke u dhënë të gjitha udhëzimet e rëndësishme rrëfimore: narracionin, përshkrimin dhe dialogun e monologun, mund ta identifikojmë atë korpus të romanit shqiptar, i cili determinon me rëndësi, në romanin bashkëkohor shqiptar.

Ai në këtë vepër tregon direkt idetë e veta dhe për këtë shkak herë-herë nëpër kapituj, dallohet ftohtësia artistike dhe estetike. Përderisa në veprat tjera u tregua mjeshtëri i rrëfimit, si te Një emër në katër rrugë, Qyteti i fundit, Një natë dhe dy agime, etj. I ndikuar nga temat e luftës së Spanjës dhe asaj italo-austriake të romaneve të Ernest Hemingway-it, Marko u tregua, mjeshtëri i stilit të tij individual, ajo që e bën atë origjinal është rrëfimi situatave dhe ngjarjeve e botës së brendshme shpirtërore e psikologjike të personazheve, duke mos imituar autorin që e admironte.

Këtë fakt e kemi sjellë me anë të krahasimeve interpozicionale të disa veprave paralele të dy autorëve, duke shtuar edhe autorë të tjerë që shkruan për të njëjtën kohë dhe të njëjtat probleme. Ndikimet janë të pranishme, por e rëndësishmja është se te këta autorë nuk ka letërsi epigonike. Të dy autorët që iu bashkuan forcave internacionale në luftën e Spanjës, janë Petro Marko, Ernest Hemingway, Georg Orwell, etj., dy të parët u njohën personalisht, gjatë aktiviteteve të ndryshme në Spanjë dhe pas përfundimit të luftës shkëmbyen letra dhe ide me njëri-tjetrin, ndërsa Orwell, qe gazetar dhe luftëtar në Katalonja.

Periudha në të cilën filloi përvoja e shkrimit të Petro Markos janë vitet e 30-ta të shek., XX, ndërsa Hemingway, e filloi atë në vitet e 20-ta të po këtij shekulli. Krijimtaria letrare e Georg Orwell-it është e lidhur ngushtë me situatën politike botërore, të kohës kur jetoi dhe veproi. Ajo është dhe do të jetë aktuale edhe në të ardhmen, ashtu si vepra e Shekspirit që u rezistoi kohërave dhe çdo herë kur i shfletojmë veprat e tij, ndjejmë kënaqësinë estetike dhe triumfin e artit mbi padrejtësitë, absurdine revoltën historike dhe luftën.

Pjesëmarrës në luftën e Spanjës ku qëndroi 112 ditë, kontribuoi për popullin e saj dhe kujtimet për këto ditë i përjetësoi në veprën historike Homazh për Katalonjën, për të cilin botuesi e kritikoi ashpër se nuk kishte ndonjë vlerë artistike, vetëm se kishte integruar pjesë të artikujve nga gazetatat që shkruanin për luftën, ose kujtimet nga ato ditë i kishte shënuar si artikuj gazetash. Në të vërtetë vepra Homazh për Katalonjën, është historiografi e luftës së Spanjës nga perspektiva e Georg Orwell-it, ajo nuk përmban elemente estetike e stilistike për tu quajtur vepër artistike, por ka rëndësi dhe peshë, për informacionin që përmban dhe për këndvështrimin ideologjik e politik të autorit.

Megjithëse u revoltova, por ajo që ndodhi më bëri akoma edhe më këmbëngulës për ta zhvilluar artin tim, kështu që unë përvesha mëngët për një punë të vështirë në rrugën e letërsisë. Ndërsa u vlerësua lartë nga Naom Chomsky, Franz Borkenau, Lionell Trilling, Che Guevara, etj. Duke nisur nga veprat që përjetësuan kujtimet e luftës së Spanjës, Homazh për Katalonjën, Për kë bie kambana, Hasta la vista dhe veprat tjera që përçojnë humanizëm, e kritikizëm ndaj

situatave politike, e ngjarjeve të turbullta, si dhe atyre pas luftës së Spanjës e luftës së dytë botërore.

Te veprat e këtyre autorëve, ka elemente humaniste antiutopike, kritike, ekzistencialiste dhe disidente, mënyra e veçantë e stilit të tyre individual paraqet një larmi të bukur artistike, stilistike dhe përmbajtjesore të veprave. Studimi si objekt të hulumtimit të brendshëm struktural ka tre rrafshë: atë narrativ, funksional dhe rrafshin e veprimit. Temat kryesore të romaneve janë mbijetesa, lufta dhe kotësia e saj, humbja e aurës etike të saj, dashuria romantike si formë shpëtimi nga kaosi dhe tragjikja, vdekja, vetëvrasja, si tema aktuale dhe ekzistencialiste.

Struktura e erudicionit, ajo letrare, shkencore, filozofike, gjuhësore dhe figuracioni i shprehjes janë emblema e romaneve. Veprat janë art unik i llojit të vet, ku mpleksen erudicioni me përvojën praktike, me ironinë që del në sipërfaqe, me figura të gjalla e të goditura që dalin nga rileximi i romaneve, mesazhin që përcjellin për ideologjinë e luftës, humbjes së jetëve njerëzore. Si diagnostifikues gjenial të këtyre kohërave, ata zbuluan cenin e qytetërimit njerëzor, duke sulmuar pa reshtur egërsinë, ku fjalët dalin më të fuqishme se bombat që binin pa reshtur në fushat e mbjella me ullinj të Andaluzisë, Katalonjës, Abruzisë, Ustikës dhe të fshatrave e qyteteve të banuara me qenie njerëzore të cilat nuk i peshonin.

Shkatërruan vepra arti dhe arkitekture, shembën tempuj fetarë e katedrale të rralla të shekujve të mesjetës, duke bërë dëme të pakthyeshme. Nën egërsinë e breshërisë së bombardimeve nuk mundën të bëjnë asgjë për mbrojtjen e tyre, edhe rojtarët më xhelozë të këtij arti të paçmuar. Vepra letrare është më e fuqishme se revolucionet popullore thotë urtësia popullore. Autorët si dëshmitarë të ngjarjeve të këtilla, me romanet e tyre, arritën të trondisin fortesat dhe shtyllat e rendit, të Frankos, Hitlerit e Musolinit, më fuqishëm se Junkerët e Gjermanisë, duke hedhur dritë mbi ato krime që bëheshin e fshiheshin, në bashkëpunim me njerëzit e Frankos, si vrasja e Federigo Garsia Lorka dhe intelektualëve tjerë, që me veprat e tyre demaskuan tradhtinë e qeverisë antipopullore.<sup>4</sup>

Ata i urrenin qeveritë reaksionare, sepse për të mbrojtur veten e tyre përdornin mjete të dhunshme, edhe n.q.s. nuk kishin i shpiknin. Tema është përpunuar në disa kapituj, në të cilët janë rrahur probleme që dalin nga vetë titulli i saj: çështjet teorike për elementet përbërëse të strukturës së tekstit narrativ (fabula dhe koncepti mbi të), strategjia narrative, në veprat e autorëve, bashkëpërkimet dhe ndikimet, ndërveprimet, fabula dhe diskursi, perspektivat e fokalizimit, koha narrative dhe koha romanore, statusi i subjektit në diskurs, funksioni didaktik, subjekti përballë ndërhyrjeve diskursive, etj.

Georg Orwell thotë se arti dhe politika janë dy elemente që ai dëshiron t'i shkrijë në veprën e tij. Të gjitha veprat e Orwell-it pa përjashtim janë artistikisht politike. Si poezia ashtu edhe proza, flasin për krimet e super shteteve ndaj njerëzve të rëndomtë. Romanet dhe poezitë, i fillon me një personazh apo dukuri të mbështjellë me një mister i cili davaritet deri në përfundimin e veprës. Orwell si homo scriptor në veprat e tij shfaq më tepër tipin se sa antitipin e tij, ai shfaq alegorikisht mendimet, idetë dhe vizionin e tij për të tashmen dhe të ardhmen. Në mënyrë revoltuese shkruan për „jo njeriun” (unperson), njeri i zhveshur dhunshëm nga të gjitha atributet e të qenurit si i tillë.

Njerëzit e tillë për Orwell-in janë të poshtëruar, të shkatërruar, të mposhtur, që kanë mbijetuar kur shpirtërisht kanë vdekur. Në veprat e tij ai krijon ura me të cilën i bart personazhet dhe ngjarjet në forma të ndryshuara, por qëllimi i mesazhit mbetet i njëjtë, ta çlirojë njeriun nga skllavëria në përgjithësi e veçmas nga ajo moderne në veçanti dhe ta bëjë vigjilent, për rreziket e shfaqura e të fshehura. Për ta analizuar veprën e Orwell-it, duhet të jemi të gatshëm për heterociklitetin e gjuhës me të cilën i paraqet ngjarjet, personazhet apo emërtimet e tyre, për të tërhequr nga shumësia e kuptimeve dhe porosive e mesazheve që përçon teksti.

---

<sup>4</sup> Petro Marko, (1978), *Hasta la vista*, Rilindja, Prishtinë, f. 352.

Ndërsa Umberto Ecco thotë se interpretimi i një vepre letrare mund të fillojë nga titulli i saj, që ai e quan çelës, atëherë Viti 1984 në roman, përfaqëson botën e pas luftës botërore atomike, i cili është botuar më 6 qershor, 1949 ! sipas kritikëve kjo vepër pasqyron vitin 1948 dhe gjithë ndryshimet politike që ndodhën atëherë me reformat në shtetet komuniste e më gjerë. Viti 1984 ka subjekt fantastik-shkencor dhe satirizon despotizmin e vëllait të madh, përgjimet, kontrollin mbi jetën dhe psikologjinë, emocionet e mendimet e shtetasve të Oqeanisë.<sup>5</sup> Për të thënë se vepra e një shkrimtari është kryesore, krahasuese, ose risimtare, duhet të shihen rrethanat e komunikimit, pranimit dhe vlerësimit të saj të cilat ndryshojnë në funksion të këtij sistemi.

Homazhe për Katalonjën është një vepër historiografike që i ka të gjitha format dialoguese të tekstit me tekste të tjera joletrare, në formë të konvencave, kodeve, miteve, normave, pjesë të artikujve, pjesë ditari, etj. Vepra letrare që i reziston kohës në një mënyrë ose tjetër, mund të thuhet se është e krahasueshme me veprat tjera, që në njëfarë forme dialogojnë ose komunikojnë me njëra tjetrën nga aspekti tematik, artistik, kulturor, ose historik. Në bazë të këtyre hulumtimeve themi se letërsia e këtij populli ose e kësaj epoke është ndikuar nga kjo letërsi kombëtare ose e kësaj epoke, ashtu siç mund të ndikohet një autor, nga një tjetër, ose nga rrethana të tjera jashtë tekstore e jashtë letrare. Sheshimi i vlerave të tre autorëve, është një punë sa e rëndë aq edhe ngazëlluese.

Nga mënyra e këndvështrimit të dukurive që parashtrajnë në veprat e tyre, temat që trajtojnë, stilin dhe gjuhën e përzgjedhur artistike që ata e përdorin dhe një sërë elementesh tjera artistike stilin si vetëreferencë, me të cilën përdorin figura të atilla që rrëfejnë për paragrafe të dhunës, kjo përfaqësohet me figurat si : simboli, metafora, metonimia, sinekdoka dhe onomatopea, paralelizmat në nivelin e kuptimitdhe gjuhës së reflektuar (enigma, mistere, devijime të qëllimshme nga kuptimi i tekstit, strukturat e barazvlefshmërisë së fjalisë në roman, sinonimet : “Përqafoheshin e putheshin e qanin e psherëtinin e shtrëngonin duart e pastaj thirrjet e përziera me “Poshtë fashizmi!”, “Rroftë liria!”, “Rrofshin garibaldinët!”, pëfunduan me këngën:”Avanti popolo!”, që buçiti në atë grykë pranë lumit Ebro.

“Mbase tani Sali kapedani, nuk e kujton atë ditë, se kushedi se sa herë do ti ketë ndodhur që t’u ketë dalë për zot atyre që merreshin nëpër këmbë nga njerëz të liq, tamqarë, imoralë, ngatërrestarë, fajdexhinj, shtypës, agallarë, arhondë, spiunë, bejlerë.”<sup>6</sup> Antonimet: :“gurë edhe re. Re edhe gurë...Lart re poshtë gurë.”<sup>7</sup> Me të gjitha këto elemente gjuhësore e stilistike që i vënë autorët në funksion të artit të tyre krijues, mund të themi se kemi të bëjmë me tre të mëdhenjtë e artit, letrar të cilët përjetimet personale, i skalitën me mjeshtërinë më të arrirë artistike. Shohim përjasje paralele, pika të përbashkëta ose të ngjashme, ndikime, përkime, por jo edhe letërsi epigonike.

Pikat e përbashkëta: lufta, humanizmi, absurdi, revolta njerëzore, metafizike dhe ajo historike. Ndikimet: vepra e Markos e frymëzuar nga Hemingway, vepra e Orwellit, e ndikuar dhe frymëzuar nga, Lufta e Ftohtë mes dy blloqeve më të mëdha në botë atij të perëndimit dhe të lindjes, si dhe nga veprat e Aldous Huxley Bota e re e guximshme (Brave New World) (1932); Ne (1924) të Yevgeny Zamyatin; Kallocain (1940) të Karin Boye; i cili e emërtoi romanin e tij sipas Leo Kall, një shkencëtar idealist suedez, që kishte një parashikim të zymtë për shtetet e reja totalitare dhe një të ardhme nën terror dhe Fahrenheit 451 (1951) të Ray Bradbury etj.

Vepra e Hemingway-it e ndikuar nga autorët :Scot Figerald, Gertrude Stain, Mark Tween, Dostojevski, Ezra Pound, Madox Ford, Lawrence, James Joyce, T. S. Eliot, etj. Situata jashtë tekstore e mbushur me ngjarje të befasishme dhe kthesa të mëdha historike në botë, ndryshimet marramendëse politike, lufta e ftohtë, acarimi i raporteve mes blloqeve.

<sup>5</sup> Georg Orwell, (2003), *1984*, Toena, Tiranë, f. 8.

<sup>6</sup> Petro Marko, (2000), *Retë dhe gurët*, Fan Noli, Tiranë.f. 451.

<sup>7</sup> Petro Marko, (2000), *Një emër në katër rrugë*, Fan Noli, Tiranë, f. 156.

Paralelizmat, Homazh për Katalonjën, Për kë bie kambana, Hasta la vista, Një natë dhe dy agime, Lamtumirë armë, Viti 1984, që përfaqësojnë paralelizmat në vija të trasha të temave të lidhura me luftën e Spanjës. Lidhshmëria, mes veprave të tre autorëve :temat e mëdha kanë të përbashkët humanizmin, absurdin e konflikteve mes popullit dhe qeverive fashiste dhe si rrjedhojë revoltën e veprimin.

Kronotopi: distopia, antiutopia, e cila është e përcaktuar në këto vepra në raport mes fuqisë së udhëheqësit dhe të revoltuarit dhe rrezikut të shpërthimit të tendosjeve në shoqëri, përplasjet mes të mashtruarve, kryengritësve dhe sadizmit të qeverive. Kryengritësit zbulojnë se nuk mund t'i realizojnë nevojat e tyre elementare dhe gjithashtu nuk mund t'i nënshtrohen rendit të përgjithshëm. Strategjitë rrëfimtare nuk janë të ngurta dhe skematike, ato janë intuitive, subjektive.

Ato nganjëherë janë nxitje nga rrethanat antiutopike të jashtme, forma e rrëfimit në vetën e tretë intradiegetik, është tipar i përbashkët i veprave të tre autorëve. Fokusi i rrëfimit te Hemingway është syri i kamerës që ai vetë e emërtoi sepse në romanet e tij fokuson ngjarjet që i quan kruciale dhe prioritare, ndërsa të tjerat janë pjesa e padukshme e stilit të icebergut. Orwell fokusohet në rrëfimin ektradiegetik, në kufizimin e dhunshëm të lirisë njerëzore, zhanri antiutopik Orwell-ian ka status të kufirit të rrezikshëm mes të lejuarës dhe të palejuarës, raportin mes të përndjekurve dhe përndjekësve, tendosjen mes ndalesës dhe rebelëve.

Ndërsa Marko përdor rrëfimin intradiegetik (tekst narrativ primar) në vetën e tretë duke u fokusuar më tepër në përshkrimin botës shpirtërore të personazheve por edhe të përshkrimeve dhe apeleve lirike e idilike të natyrës, malit, detit, natyrën e ishullit të Ustikës apo malet e Kordobës, fushat me ullinj të Katalonjës, Abruzisë e Aragonës, të cilat kishin bukuri magjepsëse, por bombardoheshin pa reshtur nga Junkerët gjermanë dhe në këto fusha u varrosën bijtë dhe bijat më të mira të Shqipërisë dhe, vendeve tjera të botës.

Lumi Ebro, si simbol i ndarjes me Anitën dhe Spanjën dhe lumi në qytetin e Udines në Itali që ia shpëtoi jetën Frederic Henry-t. Orwell është gjithashtu i prirë për ndërtimin e monologëve, atyre të brendshëm, dialogëve dinamikë (atyre që e zhvillojnë ose rekonstruktojnë fabulën) dialogë monologizues, replika dialoguese (gjestet dhe pjesët e monologut që ndërliken në narracion), rrëfime të ndërfutura me shkallëzime të larta, që përbën strukturën vertikale të narracionit dhe, është një mjeshtri në vete, etj.<sup>8</sup>

Hasta la vista ka fabul paralele. Janë të pranishme motivet dinamike (të lëvizshme që shenjojnë ngjarje) dhe statike (të palëvizshme që e shenjojnë gjendje dhe e çojnë subjektin përpara), motive të lira (logjikisht jo qenësore), motive të lidhura (logjikisht qenësore për veprimin narrativ dhe për koherencën e tyre kauzale-kronologjike). Integrimi i letrave, pjesë nga ditari, apo gazetatat janë tipar i përbashkët i tre autorëve, me të cilën karakterizohen dhe tipizohen personazhet aty shprehin idetë, emocionet, preokupimet, ideologjinë politike, statusin shoqëror, intelektual, e familjar që kanë ata. Rrethanat e vështira politike që vinin duke u përshkallëzuar, çdo ditë e më tepër dhe, rëndonin mbi supet e klasës punëtore, ose shkelnin mbi fatet e popujve dhe ndërronin kufijtë në favor të më të fortëve, ishin pretekst i mobilizimit të rinjve nga e gjithë bota për të shkuar vullnetarë në Spanjë me moton e njohur „duke luftuar fashizmin në Spanjë ata e luftojnë të keqen në gjithë botën”.

Vullnetarët e Spanjës, një pjesë e madhe e tyre intelektualë, artistë, mjekë, shkrimtarë, muzikantë, gazetarë etj., i dhanë kuptimin e një solidarizimi human që quhet luftë për lirinë e njerëzimit. Në këtë luftë ishin pjesëmarrës edhe Georg Orwell (Eric Arthur Blair), Ernest Hemingway dhe Petro Marko, tre autorë që ushtruan profesionin e gazetarit, vëzhguesit dhe luftëtarit dhe, këto kujtime i përjetësuan në kryeveprat artistike. Në këtë luftë dhanë kontributin e tyre edhe shumë intelektualë tjerë nga e gjithë bota.

---

<sup>8</sup> Zdenko Škreb, (1986), *Rečnik književnih termina*, Nolit, Beograd, f. 468.

Rrethanat që nxisin revoltën e popujve, janë absurditeti i politikës së liderëve të shteteve më të fuqishme të Europës dhe ideologjisë së saj. Sipas C. G. Jung-ut mund të jetë e karakterit mitik (Hitleri) dhe teoria e tre Rajheve. I pari i perandorisë Romake i dyti i krijuar nga Bizmarku dhe i treti nga Hitleri, i cili te çdo gjerman nxit asociacione biblike të pavetëdijshme.<sup>9</sup> Hitleri në fjalimet e veta vazhdimisht përsëriste se e njuh të quajturit e vet mistik. Ai ringjalli kultin e Votanit (zotit të erës). Simbolika e Sturmabteilung (formacione sulmi), nënkupton simbolizmin budist të diçkaje vdekjeprurëse, të pavetëdijshme.

Revolta është mënyra e vetme që të tejkalohet absurdi dhe kjo revoltë mund të jetë shoqërore, historike e metafizike. Revolta e popullit spanjoll ishte shoqërore e historike, kundër gjenocidit e shkatërrimit të përgjithshëm. Por në këtë lloj revolte në formë të tërthortë fshihet edhe ajo metafizike, që ndërlidhet me ideologjinë komuniste, e cila kishte filluar të përhapej bashkë me ndihmat që ofronte Bashkimi Sovjetik për popullin spanjoll.

Kjo nënkupton rebelimin kundër njohjes dhe pranimit të Zotit si genie absolute, që komunizmi veçse e kishte përjashtuar. Në dialogët e njerëzve, luftëtarëve dhe komunistëve kompetent e jokompetent, kemi debate e biseda të ndryshme ku diskutohet dhe vihet në pikëpyetje ekzistenca e Zotit dhe shenjtoreve. Sipas Barthes, kuptimi i rrëfimit nuk është në fund të tregimit. Ai të rrëfyerit e pret në fund të hulumtimit të sistemit të personazheve, që është aposterior dhe përbëhet:

1. Në segmentimin e tekstit sipas sekuencave.

2. Në klasifikimin e sekuencave dhe reduktimin e tyre. Sekuencat brenda episodeve (pasi një episod ka më së shumti pesë sekuenca), janë bipolare, pas sekuencës së parë, e dyta duhet të ketë karakter kundërvënës ose opozitar.<sup>10</sup>

Edhe te veprat e Petro Markos është shumë e përhapur ideja e revoltës metafizike dhe satirizimi i shenjtoreve gjatë dialogimit të personazheve, që përbën një risi në trajtimin e temës dhe subjektit, të romanit bashkëkohor shqiptar. Përveç këtij fenomeni janë edhe përshkrimet dhe ndërtimi i personazheve, me nota reale, me gjithë mangësitë dhe përparësitë e tyre, duke mos i ndarë në bardhe zi dhe personazhe pozitive ideale dhe negative me plot kuptimin e fjalës. Vepra e tij e tërheq lexuesin nëpër një sprovë, që ia bën të ditur si bie tirani.

Heronjtë e romaneve të Markos janë moral, ekzistencial, real dhe të imagjinuar. Gori, Anita personazhet tjerë që mund t'i quajmë, kryesorë në njëfarë mase e përcaktojnë hapësirën dhe rëndësinë e veprimit të tyre, si dhe rëndësinë e veprimit të personazheve tjerë episodikë dhe dytësorë. Ai Gori Gjinlekën e paraqet si gjedhe të virtytit moral, i cili ndjen dhimbje dhe empati ndaj të varfërve, pleqve dhe sidomos kundërshton ashpër dhunën ndaj femrës. Reflektorët e fokusit i vendos tek protagonistët kryesorë, duke i paraqitur ata me besueshmëri dhe realizëm.

## Përfundim

Georg Orwell, në romanin 1984, thotë: “Ta thaush të vërtetën, në kohëra të turbullta, përbën akt revolucionar”<sup>11</sup>. Ai është i njohur për satirën sardonike, në të gjitha romanet e tij. Petro Marko është më i prirë për pauza deskriptive, se sa Ernest Hemingway, ai merret me përshkrimin lirik të natyrës, përdor metoniminë, metaforën, sinekdokën, e përdor figuracionin stilistik për të arritur efekt emotiv, për të shprehur dinjitet dhe për ta shenjuar sublimen, si në ambientin e jashtëm dhe të brendshëm edhe në përshkrimin e botës shpirtërore e psikologjike të personazhit. Ndërsa Orwell, përdor alegorinë dhe ironinë në përshkrime dhe sekuenca të episodeve në romanet e tij, sidomos Viti 1984, si dhe shpesh satirën sardonike, Homazhe për Katalonjën, etj.

<sup>9</sup> Carl Gustav Jung, (2006), *Psikologjia analitike*, Fan Noli, Tiranë, f. 186.

<sup>10</sup> Cvetan Todorov, (2000), *Poetika e prozës*, Panteon, Tiranë, f. 111.

<sup>11</sup> Georg Orwell, (2003), *1984*, Toena, Tiranë, f. 57.



Ai me stilin e përdorur në romane përfaqëson botën e ashpër dhe paskrupull të personave të brendshëm të partisë dhe vëllait të madh, ashtu siç i emërton ministritë :e dashurisë, bollëkut, krimi i mendimit, Oqeania, Euroazia etj., paraqet tingullin-simbol i cili rrëfen për sugjestione të errëta, e të turbullta. Si në aspektin alegorik të të rrëfyerit ashtu edhe në atë semantik e semiotik. Ndërsa Hemingway përdor devijime dhe zhvendosje gjuhësore e stilistike në rrëfime, duke përdorur fjali të shkurtra, frazeologjizma, të pasura me figurën e alegorisë, poliseminë, metaforën, metoniminë etj.

Një tip subjekti që hasim më shumë te veprat e Ernest Hemingway-it dhe më pak te Petro Marko, është ai me aksion-veprim të brendshëm, ku veprimet themelore zhvillohen në botën e brendshme të personazhit dhe ndikojnë në zbulimin e dinamikës së asaj bote. Si romane që trajtojnë tema lufte aty ka aksione dhe aktivitete, beteja, fatkeqësi natyrore, shoqërore etj., por thelbi i këtij stili është i veçantë, ai i Icebergut, ku ka më shumë lëvizje dhe veprime të brendshme në psikologjinë e personazhit, lëvizje të cilat çojnë përpara subjektin e veprës, rrëfime të ndërthurura me frazeologjizma e polisemi,që fshehin shumë e zbulojnë pak dhe, që përbën stilin individual të tij atë të iceberg-ut.

## Referencat

- [1]. Marko, P. (1078), *Hasta la vista*, Rilindja, Prishtinë.
- [2]. Hemingway, E. (2010), *Lamtumirë armë*, Fan Noli, Tiranë.
- [3]. Hemingway, E. (2010 ), *Për kë bie kambana*, Fan Noli Tiranë.
- [4]. Orwell, G. (2003), 1984, Toena, Tiranë.
- [5]. Solar, M. (1976), *Teoria književnosti*, Globus, Zagreb.
- [6]. Todorov, C. (2000), *Poetika e prozës*, Panteon, Tiranë.
- [7]. Theodor W. Adorno, (2003), *Can One Live After Auschwitz*, Stanford University Press.
- [8]. Барт, Р. Амон, Ф. (1996), *Теорија на прозата*, Сигмапрес, Скопје.
- [9]. Константинович, З. (1984), *Увод у упоредно проучавање књижевности*, Нолит, Београд.
- [10]. Лотман. Ј. (2005), *Структурата на уметничкиот текст*, Детска радост, Скопје.
- [11]. Пажо, Д А. (2002 ), *Општа и компаративна книжевност*, Скопје.
- [12]. Шеврел, И. (2005), *Компаративна литература*, Детска радост, Скопје.
- [13]. Pichois, Cl. Rousseau, A.M. (1973), *Komparativna književnost*, Globus, Zagreb.
- [14]. Genette, G. (1982), *Figures of literary discourse*. New York.
- [15]. Škreb, Z. (1986), *Rečnik književnih termina*, Nolit, Beograd.
- [16]. Škreb, Z. & Stamać, A. (1986), *Uvod u književnost, teorija, metodologija*, GLOBUS, Zagreb.
- [17]. Sartre, J. P. (2006), *Qenia dhe hiçi*, Toena, Tiranë.
- [18]. Umberto Eco, (2010), *Struktura e papranishme*, Dukagjini, Pejë.